

# GJYKATA KUSHTETUESE E KOSOVËS – HISTORIKU, ROLI DHE NDIKIMI I VENDIMEVE TË SAJ

## **Abstrakt**

Trajtimi i lindjes dhe zhvillimit të Gjykatës Kushtetuese është me rëndësi, ngase s' do mend që Gjykata Kushtetuese përpos që paraqet mekanizem të mbrojtjes së kushtetutshmërisë, ajo paraqitet edhe si mekanizem i rëndësishëm në ruajtjen e stabilitetit politik dhe me gjerë në një vend e posaçërisht në Kosovë, ku edhe është orientuar punimi i kësaj teme.

Paraqitja e Gjykatës Kushtetuese dhe zhvillimi i saj në Kosovë ka kaluar nëpër periudha të ndryshme. Gjykata Kushtetuese paraqet atribut të shtetësisë në Kosovë, së cilës i është besuar autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese ndikuan dukshëm në tejkalimin e krizave shoqërore dhe politike në vend. Veç kësaj, Gjykata Kushtetuese në Kosovë luan rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Prandaj, në bazë të rolit që i është dhënë Gjykatës Kushtetuese, edhe vendimet e saj janë të obliguara për të gjitha institucionet e tjera

Pra, ky punim ka për qëllim të trajtoj Gjykatën Kushtetuese, duke filluar nga historiku, zhvillimi, roli e deri tek ndikimi i vendimeve të saj. Qëllim parësor i punimit të kësaj teme është të pasqyrohet në mënyrë kronologjike themelimi dhe zhvillimi i Gjykatës Kushtetuese në Kosovë që nga koha e okupimit e deri te themelimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Mirëpo, ky nuk është qëllimi i vetëm, sepse nëpërmjet këtij punimi dëshirohet të tregohet roli i Gjykatës Kushtetuese si mekanizëm i mbrojtjes së Kushtetutës, por jo vetëm aq, por edhe ndikimi i vendimeve të Gjykatës në tejkalimin e krizave dhe mbrojtjen e rendit dhe të drejtës në vend. Po ashtu, qëllimi i këtij punimi është edhe roli i madh që luan Gjykata Kushtetuese në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të përcaktuara me kushtetutë përmes instrumentit të njohur si ankesa individuale.

Prandaj, duke kujtuar këto qëllime edhe kapitulli i parë i referohet hapave të parë të Gjykatës Kushtetuese, duke filluar me historikun dhe zhvillimin e Gjykatës në kohët më të vështira të

kombit shqiptar në Kosovë, funksionit, kompetencat e saj me Ligjin Kushtetues të KSA të Kosovës të vitit 1969, për të vazhduar pastaj me zgjerimin e kompetencave me Kushtetutën e vitit 1974, si dhe raportin e saj me Gjykatën Kushtetuese të RS të Serbisë dhe të Federatës Jugosllave. Tutje, në kapitullin e parë trajtohet formimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës pas pavarësisë së Kosovës, modelin të cilit i përket Gjykata Kushtetuese, rolin e saj si gardian i Kushtetutës, juridiksioni e deri te fuqia dhe efekti juridik i vendimeve të saj, instrumentet e zbatimit të këtyre vendimeve si dhe obligimi i zbatimit të tyre.

Kapitulli i dytë është i orientuar në kontrollin kushtetues, me theks të veçantë në kontrollin abstrakt. Në këtë kapitull rëndësi të posaçme i është kushtuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës të Kosovës, duke marrë për bazë dhe argument rastet më të spikatura dhe me të rëndësishme me të cilat u bë sqarimi i shumë çështjeve kushtetuese e vendime të cilat drejtpërdrejtë zbuten tensionet e jetës politike në vend.

Ndërsa, kapitulli i tretë i kushtohet kontrollit konkret, përkatësisht referimit incidental duke elaboruar të drejtën e gjykatave të rregullta për referim pranë Gjykatës Kushtetuese, gjithnjë duke iu referuar dhe duke pasur për bazë praktiken gjyësore të Gjykatës Kushtetuese. Tutje, kapitulli i tretë përfshinë ankesën individuale kushtetuese si instrument i rëndësishëm i mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në mënyrë të veçantë përmendet roli i vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe obligimi kushtetues i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës që interpretojnë e të drejtave dhe lirive të njeriut ta bëjnë në pajtueshmëri me vendimet e Gjykatës së Strasburgut.

Për t'i realizuar qëllimet e lartpërmendura dhe për të pasur më lehtë rrugën e përfundimit të kësaj teme kemi shtruar këto pyetje kërkimore-shkencore:

- 1.) Cila ka qenë pozita e Gjykatës Kushtetuese gjatë periudhës 1968-1999?
- 2.) Cili është roli i Gjykatës Kushtetuese në sistemin kushtetues të Kosovës?
- 3.) Cili është roli i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në zgjidhjen e krizave politike dhe shoqërore në vend?
- 4.) Cili është roli i Gjykatës Kushtetuese në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut?
- 5.) Cili është raporti i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut?

Për të përmbushur temen tonë dhe për ti dhënë përgjigje këtyre pyetjeve ne kemi përdorë disa metoda shkencore. Kështu është aplikuar metoda historike, metoda kualitative, metoda e dokumnetimit, metoda e klasifikimit, metoda e krahasimit, si dhe metoda e deskripcionit(përshkrimit).

**Fjalët kyçe:** Kushtetuta, Gjykata Kushtetuese, Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, Kontrolli Abstrakt, Kontrolli Konkret.